



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

### ***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***12 - 14 Mars 2016***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



# Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

## Mbi 1.000 thirrje për një javë në "Alo doktor"



Gjatë javës së kaluar 1.121 pacientëve kanë kërkuar këshilla mjekësore në linjën telefonike "Alo doktor". Nga 15 shtatori i vitit 2014 deri dje, në numrin 02/15 123 ka pasur 81.444 thirrje.

Siç njoftojnë nga NPSH Shtëpia e Shëndetit Shkup, paraqitjet janë për spektër të gjerë të simptomatologjisë më të ndryshme. Më së shpeshti për dhimbje koke, viruse stomaku, tension të lartë gjaku, ftohje sezonale, dhimbje simptomatike dhe këshilla të ndërlidhura me sëmundje kronike.

Të gjithë personave, të cilët kanë kërkuar këshillë mjekësore në linjën telefonike u është dhënë ndihmë shëndetësore me këshillë dhe terapi përkatëse simptomatike.

Linja është e hapur çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim i menjëhershëm mjekësor në momentin e paraqitjes së çfarëdo lloj simptomave të çrregullimit të shëndetit.

Thirrjet janë nga qytetarë nga të gjitha qytetet e Maqedonisë, ndërsa 25 mjekë janë në dispozicion për këshilla mjekësore.



## Pacientët me diabet në panik, nëpër barnatore ka mungesë insuline



**Shkup, 11 mars** - Shoqata e personave të diagnostifikuar me diabet, "Balance", thotë se në muajt e fundit, pothuajse në të gjitha barnatoret mungon insulina.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Kjo shoqatë ka kërkuar takim në ministrinë resore, por nuk i ka pritur askush, ndërkaq kur mungon një lloj insuline, të sëmurët me diabet e zëvendësojnë me ndonjë lloj tjetër.

Sipas Cvete Serafimovski nga "Balance", kjo është në dëm të pacientëve, pasi që rrezikohet jeta. Serafimovski thotë se organizmit i duhet kohë që të përshtatet me ilaçin e ri, nëse e pranon, ndërkaq duhet që insulina të ndrohet në kushte klinike kur pacienti është në mbikëqyrje të vazhdueshme mjekësore.

Kjo shoqatë thotë se janë publikuar specifikat e tenderit të ri për blerjen e insulinës, me të cilin zvogëlohen sasi të insulinës analoge bashkëkohore, por rriten ato humane. Sipas tyre, në tenderin e fundit, 90% e insulicës ishte bashkëkohore, që më pastaj të bie në 75%, kurse me specifikat e fundit, insulina bashkëkohore është 55% nga sasia e përgjithshme. Kjo ndodh për shkak të ndryshimit të detyruar të llojit të insulinës nga pacientët.



## Todorov ende "nuk dëgjon" specialistët (Video)



Një muaj pas protestës së specialistëve para Ministrisë së Shëndetësisë, askush nga autoritetet shëndetësore nuk i ftoi mjekët e rinj në takim. Specialistët ankohen se Ministria nuk ka vesh për shqetësimet e tyre dhe se ministri Todorov sjell zgjidhje të pjesshme. Ata kërkojnë të zgjidhet statusi i të gjithë specialistëve, të marrin rrogë, të jenë të siguruar dhe të ndërpritet regjistrimi i provimeve dhe transmetimi i tyre direkt në ueb faqen e Ministrisë.

"Aktiviteti i tij i fundit është programi i bashkëfinancimit i specialistëve privat, program që duhet të zgjidhë deficitin e personelit me një pjesë të specialistëve privat. Kemi sërish ri-shtresim të specialistëve privat dhe diskriminim, nuk jemi kundër punësimit të specialistëve privat, por jemi kundër zgjidhjeve të pjesshme, sepse me këtë program do të punësohen 100 specialistë, ndërsa 500 do të mbesin pa paga", tha Biljana Dodeva- specializante, njofton Alsat-M.

Ministri i Shëndetësisë ka theksuar se është jokorrekte ai të fajësohet edhe pse përpiqet ta zgjidhë problemin me programin e bashkëfinancimit përmes të cilit shumica e specialistëve privat do të marrin një rrogë mesatare të Maqedonisë dhe do tu paguhet një pjesë e bursës.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



“Nuk mundet të përgjigjet ai që angazhohet ta zgjidh problemin, që dikush tjetër e ka bërë. Tani unë kam një ndjenjë të tillë se dikush ka bërë më parë problem, dhe kjo është se ka specializantë privat, ajo nuk ekziston askund, përveç këtu, të cilët paguajnë para të majme për tu edukuar dhe të punojnë”, tha Nikolla Todorov-Ministër i Shëndetësisë. Specializantët thonë se nuk do të ndalen këtu dhe do të vazhdojnë të luftojnë për kërkesat e tyre. Ata thonë se për problemet e tyre i informojnë edhe institucionet ndërkombëtare nga fusha e shëndetësisë.

**PORTALB**  
dritare realiteti

## Barazohet shkalla e lindjeve dhe vdekjeve në Maqedoni



Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të statistikave numri i lindjeve të foshnjave nga viti 2014 deri në vitin 2015 ka shënuar rritje të vogël, përkatësisht për 458 fëmijë më shumë.

Gjendja me natalitetit është për t'u shqetësuar se popullata në Maqedoni po plaket, njofton TV 21.

Sipas Entit për statistika për tre muajt e fundit të vitit 2015 lindje më të mëdha të foshnjave ka pasur Shkupi me 1650, ndërsa më pas vijojnë Tetova me 301 dhe Kumanova me 298 lindje. Kurse me numër më të vogël janë Demir Kapija me Dojranin me 8 fëmijë, Vevçani me 4, dhe Lozova vetëm 2 lindje.

## Maqedoni, nëpër barnatore ka mungesë insulin



Shoqata e personave të diagnostifikuar me diabet, "Balance", thotë se në muajt e fundit, pothuajse në të gjitha barnaret mungon insulina, transmeton Telegrafi Maqedoni.

Kjo shoqatë ka kërkuar takim në ministrinë resore, por nuk i ka pritur askush, ndërkaq kur mungon një lloj insuline, të sëmurët me diabet e zëvendësojnë me ndonjë lloj tjetër.

Sipas Cvete Serafimovski nga "Balance", kjo është në dëm të pacientëve, pasi që rrezikohet jeta. Serafimovski thotë se



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



organizmit i duhet kohë që të përshtatet me ilaçin e ri, nëse e pranon, ndërkaq duhet që insulina të ndrohet në kushte klinike kur pacienti është në mbikëqyrje të vazhdueshme mjekësore.

Kjo shoqatë thotë se janë publikuar specifikat e tenderit të ri për blerjen e insulinës, me të cilin zvogëlohen sasi të insulinës analoge bashkëkohore, por rriten ato humane. Sipas tyre, në tenderin e fundit, 90% e insulinës ishte bashkëkohore, që më pastaj të bie në 75%, kurse me specifikat e fundit, insulina bashkëkohore është 55% nga sasia e përgjithshme. Kjo ndodh për shkak të ndryshimit të detyruar të llojit të insulinës nga pacientët.



## Nesër skadon afati për parashtrimin e paraqitjeve tatimore vjetore

**Nesër skadon afati për dorëzimin e paraqitjeve tatimore vjetore për të ardhurat e realizuara shtesë gjatë vitit 2015. Këtë vit në Drejtorinë për të Ardhura Publike presin që të dorëzohen 400.000 paraqitje...**



Paraqitjet tatimore vjetore (PTV) detyrimisht parashtrihen për të ardhura të realizuara, përveç rrogës ose pensionit ose të ardhurat nga veprimtaria bujqësore/veprimtari e pavarur, të ardhura nga qiratë nga dhënia e pronës - me qira ose nënqira, të drejta autoriale, pronësi industriale, dividendë e paguar, përfitim kapital nga shitja e pjesëmarrjes në kapital dhe pronë e patundshme, fitim nga lojërat shpërblyese në vlerë më të madhe se 5.000 denarë, të ardhura të realizuara nga lojërat e fatit përmes internet faqeve të huaja të specializuara.

Paraqitje tatimore vjetore duhet të parashtrihen edhe për të ardhura personale nga vendet e huaja, angazhimi i punës në ambasadë, mision në organizatë ndërkombëtare, të ardhura të realizuara përmes internetit si e-tregti, shërbime të kryera përmes faqeve të specializuara për shembull [www.freelancer.com](http://www.freelancer.com), [www.upwork.com](http://www.upwork.com), vendosje të reklamave në internet faqet personale, parashikime të tipeve për ndeshjet sportive dhe të ardhura të tjera shtesë, jashtë pagës ose pensionit të rregullt.

Qytetarët, të cilët gjatë vitit të kaluar kanë realizuar të ardhura në bazë të kompensimit nga marrëveshjet për vepër, marrëveshje autoriale dhe marrëveshje të tjera, për të cilat ka ekzistuar detyrim për pagesë kontribute speciale për të ashtuquajturit "honorarë" konform dispozitave të Ligjit për kontribute nga sigurimi i domosdoshëm social në zbatim nga 1 janari i vitit 2015 deri më 31 korrik të vitit 2015, nevojitet që të shprehen në mënyrë përkatëse edhe në paraqitjen tatimore vjetore, varësisht nga lloji i pagesës.

Paraqitja tatimore vjetore është falas dhe mund të ndërmerret nga ueb faqja e DAP-it, ndërsa mundet të dorëzohet drejtdrejtë në DAP përmes postës ose në mënyrë elektronike.(mia.mk)